

## STATUT

I

## shoqërisë tregtare

## “PAYAL” SHPK

Tirane me 10.01.2025

## Neni 1

## Ortakët e shoqërisë

Ortakët e shoqërisë “PAYAL” SHPK janë:

**Intelisoft shpk**, shoqeri shqipitare me nipt L91702001P me adresë Tirane, Tirane, TIRANE Rr.233, Ap nr 3, Numri i Pasurise 4/9+1-N3, Zona Kadastrale me administrator Znj. Dhurata Lohja

I

## Neni 2

## Personaliteti juridik

- Shoqëria “PAYAL” SHPK, nga këtu e më poshtë referuar si shoqëria, e fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).
- Shoqëria është person juridik shqiptar e cila zhvillon aktivitetin në përputhje me ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” dhe këtë Statut.

## Neni 3

## Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

**Shoqëria ka për objekt veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të përshkruara në vijim: Emetimin e parasë elektronike; Dërgesat e parave; Këmbim valutor; Shërbime si Agjent ne Sigurime; Shërbimin e inicimit të pagesave; Shërbimin e**



*Ilogarisë; Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për veprimtaritë financiare për të cilat është licencuar; Menaxhim projektesh në sistemin informatik; Import, eksport, ndërmjetësime, agjent komisioner, tregti artikuj të ndryshëm, makineri, pajisje dhe produkte për nevojat e veta dhe për të tretë; Menaxhim database (të dhënash informatike); Konsulencë në Zhvillimin e sistemit informatik; Konsulencë dhe informim mbi sistemin e sigurisë informatike; Konsulencë mbi teknologjinë informatike në sektorin finansiar dhe atë bankar në veçanti; Teknologji informacioni (information technology); Zgjidhje telekomunikacioni (telecommunication solutions); Shoqëria mund (i) të marrë pjesë me financime ose në mënyrë operative në consortium-e edhe të përkohshme, joint venture ose (ii) të zotërojë, të blejë ose të shesë pjesëmarrje në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi që kanë qëllime të ngjashme, komplementare apo gjithsesi të lidhura me të;*

#### Neni 4

##### Selia e shoqërisë

1. Shoqëria ka selinë e saj në adresën: *Rr. Ismail Qemali Nr. 2, Tiranë, Shqipëri*
2. Shoqëria mundet të shtrijë aktivitetin e vetë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mundet të themelojë degë, ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë tij.
3. Selia e shoqërisë mundet të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Asambleës së ortakëve të shoqërisë.

#### Neni 5

##### Kohëzgjatja e shoqërisë

1. Periudha e aktivitetit të shoqërisë është e *papërcaktuar*.
2. Çdo ndryshim në lidhje me periudhën e aktivitetit mundet të bëhet vetëm nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, me vendim.

#### Neni 6

##### Të dhënat në korrespondencat dhe dokumentet e tjera të veprimtarisë

Të gjitha shkresat, formularët e urdhreve apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përbajnë të dhënat e mëposhtme:

faqe 2



nxjerrë nga shoqëria, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përbajnë të dhënat e mëposhtme:

- numrin unik të identifikimit;
- formën ligjore të shoqërisë;
- vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
- të dhëna nëse shoqëria është në likuidim.
- Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

**Neni 7****Kapitali Themeltar**

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **140.000 Lekë**.
- Kapitali themeltar është i ndarë në **1 (një) kuota** me vlerë nominale **140,000 Lekë** secila.
- Pjesëmarrja me kuota e ortakëve është si më poshtë:
  - **Intelisoft** zotëron **100%** të kuotave të shoqërisë;

**Neni 8**

Pronësia mbi kuotat dhe veprimet me to regjistrohen në regjistrin që shoqëria mban për këtë qëllim dhe që përmban detyrimisht të dhënat e mëposhtme:

- emrin, mbiemrin, numrin e pasaportës dhe adresën e pronarit të kuotës;
- vlerën nominale dhe numrin e kuotave në pronësi;
- emrin, mbiemrin, numrin e pasaportës dhe adresën e pronarit të ri të kuotës në rast transferimi;
- të dhënat e kontratës me të cilën është bërë transferimi i pronësisë mbi kuotën.

**Neni 9****Transferimi i kuotave ndërmjet ortakëve**

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

**Neni 10**

**Transferimi i kuotave me trashëgimi**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkëshortëve si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.
2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë mundet të transferohen lirisht midis prindit dhe fëmijës ose anasjelltas.

**Neni 11****Kalimi i kuotave tek të tretët**

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët.

**Neni 12****Organet e shoqërisë**

Drejtimi dhe administrimi i shoqërisë bëhet nëpërmjet organeve të saj që janë:

- Administratorët.
- Asambleja e Përgjithshme.

**Neni 13****Administratorët**

Administratorët e shoqërisë janë:

- **Znj.Blerta Uke Pemaj**, shtetase shqiptare e datëlindjes 18.03.2001, lindur në Puke Shkodër, dhe banuese në Tiranë, identifikuar nga karta e identitetit me nr. Personal K15318034M, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar
- Administratori do t'i ushtrojne kompetencat e tij te te administrimit veçmas me perjashtim te veprimitarive ne vijim te cilat do te ushtrohen me vendim te asamblese se oratakeve;
- Nenshkrimi i kontratave te veçanta te shitjes me një vlore mbi 5.000,00 (pesë mij®) euro secila;
- Nenshkrimi i kontratave te veçanta te blerjes<sup>SHP</sup> me një vlore mbi 5.000,00 (pesë mijë) euro secila;
- Pagesa me vlore me teper se 5.000,00 (pesë mijë) euro secila me perjashtim te pagesave ndaj administrates tatimore dhe thesarit te shtetit;
- Themelimi i shogerive te do lloj forme, te degeve, konsorciumeve ose enteve kolektive te do lloji;



### Emërimi i administratorit

1. Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratori është person fizik i cili mund të zgjidhet edhe jashtë bashkësisë së ortakëve të shoqërisë.

### Neni 15

#### Kohëzgjatja e mandatit

1. Akti për emërimin e administratorit përcakton gjithashtu dhe kohën e qëndrimit në detyrë të tij. Nëse kjo nuk është e përcaktuar në aktin e emërimit, kjo periudhë nuk mundet të jetë më e gjatë se *pesë vjet*, duke filluar ky afat nga data e emërimit.
2. Në rast dorëheqje/shkarkimi Asambleja e Përgjithshme, jo më vonë se 2 javë nga momenti i njoftimit të dorëheqjes ose shkarkimit, emëron me vendim Administratorin e ri të shoqërisë.

### Neni 16

#### Shkarkimi i Administratorit

1. Administratori shkarkohet për shkaqe të përligjura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Do të konsiderohen shkaqe të përligjura të gjitha veprimet me faj të rendë të Administratorit, paaftësia e tij në kryerjen korrekte të funksioneve, mosbatimi hapur i vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme, mosrespektimi i dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare dhe Statutit të shoqërisë, në përgjithësi çdo veprim i Administratorit i cili dëmton ose mund të dëmtojë rendë interesin e shoqërisë.

### Neni 17

#### Kompetencat e Administratorit

1. Secili prej administratorëve, në mënyrë individuale, ka kompetenca të plota për të vepruar në çdo rrethanë në emër të shoqërisë, gjithmonë brenda objektit të aktivitetit të shoqërisë, duke u kufizuar në ato kompetenca që ligji ose ky Statut ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.
2. Për veprime të cilat e detyrojnë shoqërinë në një vlerë më të madhe se **10 000 (dhjetë mijë) Euro në Muaj**, administratorët duhet të marrin më parë, miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
3. Administratori i shoqërisë ka këto të drejta dhe detyrime:
  - a) përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
  - b) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarisë tregtare të shoqërisë;



- duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - e) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
4. Shitia dhe/ose blerja e pasurive të paluajtshme do të konsiderohet e vlefshme nëse për të është marrë pëlgimi paraprak i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Në këtë rast vendimi përkatës i Asamblesë do të konsiderohet i vlefshëm, nëse ortakët që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit të shoqërisë, kanë votuar në favor të shitjes dhe/ose blerjes së pasurisë në fjalë.
  5. Administratori përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve të shoqërisë, duke përfshirë vendimet dhe procesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 18****Asambleja e Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpérblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;



- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) shitjen e pasurive të paluajtshme të shoqërisë;
  - j) blerjen e pasurive të paluajtshme të shoqërisë;
  - k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

**Neni 19****Thirrja e mbledhjes së asamblesë**

1. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Mbledhja e asamblesë thirret nga administratori ose likuiduesi/t.
3. Pavarësisht nga sa përcaktohet në paragrin e mësipërm, ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, duke respektuar rregullat që ligji dhe ky statut parashikon edhe për thirrjen e asamblesë nga Administratori.
4. Nëse, në kundërshtim me paragrin 2 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme nuk thirret ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës secili prej ortakëve që kanë bërë kërkesën ka të drejtë:
  - a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse

administratorët nuk përbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

5. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të këtij nenit dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 20 të Statutit.

### **Neni 20**

#### **Mënyra e njoftimit**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Bashkë me njoftimin ortakëve u duhet dërguar edhe dokumentacioni që ka lidhje me rendin e ditës.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 21**

#### **Përfaqësimi i një ortaku**

1. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 22**

#### **E drejta e votës**

1. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
2. Ortakët që nuk janë të pranishëm mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
  - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
  - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të



- shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë se Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

**Neni 23****Përjashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**Neni 24****Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë**

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.
2. Prosesverbali duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryesuesit të mbledhjes dhe të mbajtësit të procesverbalit, si dhe rezultatet e votimit.
3. Kryesues i mbledhjes mund të jetë njëri prej ortakëve ose personi që ka thirrur mbledhjen, ndërsa mbajtësi i procesverbalit (sekretari) zgjidhet nga kryesuesi i mbledhjes.
4. Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
5. Prosesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
6. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të



mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

**Neni 25****Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë pér çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas ligjit pér shoqëritë tregtare, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
3. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 e 2 të këtij nenit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 26****Marrja e vendimeve**

Asambleja e Përgjithshme vendos në çdo rast me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, pér të gjitha çështjet që kanë lidhje me aktivitetin tregtar dhe/ose organizimin e shoqërisë.

**Neni 27****Modalitetet e zmadhimit të kapitalit**

1. Kapitali themeltar zmadhohet nëpërmjet emetimit të kuotave të reja ose nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të kuotave ekzistuese.
2. Kuotat e reja shlyhen me para në dorë, me kompensim të një kredie në para të kerkueshme dhe të detyruar pér t'u shlyer nga shoqëria, me përfshirje të rezervave, fitimeve apo primeve të emetimit, me kontribut në natyrë etj.
3. Në rastin e kontributeve në natyrë, vlerësimi i tyre bëhet prej një ose më shumë ekspertëve pér kontributet të caktuar me vendim nga gjykata në bazë të kërkesës së bërë nga Administratori i shoqërisë.
4. Raporti i ekspertit/ekspertëve të kontributeve vihet në dispozicion të ortakëve në selinë e shoqërisë.

**Neni 28**

**Modalitetet e zvogëlimit të kapitalit**

1. Zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë në përpjesëtim me vlerën e kuotave që zoterojnë.
2. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, të paktën 45 ditë përpara mbledhjes së asamblesë së ortakëve që thirret për të vendosur mbi këtë projekt.
3. Asambleja merr vendim mbi raportin e ekspertëve kontabël të autorizuar, të cilët jasin vlerësimin e tyre mbi shkaqet dhe kushtet e zvogëlimit.

**Neni 29****Ushtimi i kontrollit nga ekspertët kontabël të autorizuar**

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga një ekspert kontabël të autorizuar.

**Neni 30****Kohëzgjatja e mandatit dhe zëvendësimi**

1. Ekspertët kontabël të autorizuar emërohen për një vit finanziar. Funksionet e tyre përfundojnë pas mbledhjes së asamblesë e cila merr vendim mbi llogaritë vjetore.
2. Eksperti kontabël i autorizuar, i emëruar nga asambleja për zëvendësimin e një tjetri, mbetet në funksion deri në fundin e mandatit të paraardhësit të tij.

**Neni 31****Përgjegjësia e ekspertëve**

1. Ekspertët kontabël të autorizuar janë përgjegjës si ndaj shoqërisë, ashtu dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme që rrjedhin nga fajet dhe nënvlefësimet e tyre në ushtrimin e funksioneve përkatëse.
2. Ata nuk janë ligjërisht përgjegjës për shkeljet e ligjit të kryera nga Administratori, me përjashtim të rasteve kur kanë pasur dijeni për to, por nuk i kanë zbuluar në raportin për mbledhjen e asamblesë.

**Neni 32****Shpërndarja e fitimeve të shoqërisë**

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

**Neni 33**

**Kufizimet e shpérndarjeve, certifikata e aftësisë paguese**

1. Shoqëria mund t'u shpérndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendifit:
  - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
  - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.
2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpérndarja e propozuar e dividentëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij nenit, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpérndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
3. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

**Neni 34**

**Prishja e shoqërisë**

Shoqëria do prishet:

- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit/likuidimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtarë për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- c) me vendim të gjykatës;

**Neni 35**

**Likuidimi i shoqërisë**

Likuidimi i shoqërisë kryhet në përputhje dhe në respektim të kushteve dhe procedurave të parashikuara nga dipozitat përkatëse ligjore.

**Neni 36**

**Fuqia e akteve**

Të gjitha çështjet për të cilat Statuti nuk i parashikon ose nuk i rregullon në mënyrë të posaçme do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" të cilat parashikojnë mënyrën e organizimit, funksionimit dhe kontrollit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.



Të gjitha çështjet për të cilat Statuti nuk i parashikon ose nuk i rregullon në mënyrë të posaçme do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" të cilat parashikojnë mënyrën e organizimit, funksionimit dhe kontrollit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

### **ORTAKËT**

Intelisoft shpk

Tirane me 10.01.2025

